

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO



FLETUDHËZIM PËR PACIENTË

Enap[®] tableta 5 mg
Enap[®] tableta 10 mg
Enap[®] tableta 20 mg
 Enalapril maleat

Lexojeni gjithë fletudhëzimin me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'ua bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njejta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor i cili nuk është përfshirë në këtë fletudhëzim, ju lutemi informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Përmbajtja e fletudhëzimit:

1. Çka është Enap dhe për çka përdoret
2. Çka duhet të dini para se të merrni Enap
3. Si ta merrni Enap
4. Efektet anësore të mundshme
5. Si ta ruani Enap
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË ENAP DHE PËR ÇKA PËRDORET

Enap është një bar që i përket grupit të frenuesve të enzimës angiotensin konvertazë (ACE inhibitorët). Bari vepron duke zgjeruar enët e gjakut, dhe kjo çon në uljen e tensionit të gjakut. Te pacientët me insuficiencë të zemrës, Enap përmirëson funksionin e punës së zemrës.

Enap indikohet në:

- trajtimin e tensionit të lartë të gjakut;
- trajtimin e insuficiencës së zemrës;
- parandalimin e përkeqësimit të funksionit të zemrës dhe ngadalësimin e zhvillimit të simptomave te pacientët me fazat e hershme të insuficiencës së zemrës, d.m.th. në periudhën kur simptomat nuk janë paraqitur ende;
- parandalimin e komplikimeve të rënda të papritura (rastet koronare ishemike) te pacientët me disfunkcion të ventrikulit të majtë.

2. ÇKA DUHET TË DINI PARA SE TË MERRNI ENAP

Mos e merrni Enap:

- nëse jeni alergjik (të mbindjeshëm) ndaj enalapril, apo në ndonjërin nga përbërësit tjerë të barit (të listuara në seksionin 6);
- nëse më parë keni përjetuar reaksione të mbindjeshmërisë të karakterizuara me ënjtje të papritur të buzëve dhe fytyrës, qafës, madje edhe duarve dhe këmbëve ose nëse është shfaqur marrje e frymës (ngulfatje) ose ngjirje zëri (angioedemë) pas përdorimit të frenuesve të tjerë të ACE;
- nëse vuani nga angiodema e trashëguar ose nga angioedema për shkaqe të tjera;
- nëse jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë (është gjithashtu më mirë të mos përdoret Enap edhe në fillim – lexoni më poshtë te pjesa Shtatzënia dhe ushqyerja me gjë).

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

- nëse keni diabet apo funksionim të dëmtuar të veshkave dhe trajtoheni me barëra që ulin presionin e gjakut të cilat përmbajnë aliskiren.
- nëse keni marrë ose nëse aktualisht merrni sakubitril/valsartan, bar i cili përdoret për trajtimin e llojit afatgjatë (kronik) të insuficiencës së zemrës të rriturit, si rrezik nga angioedema (enjtja e shpejtë nën lëkurë në rajonin e fytyrës) është e rritur.

Nëse ndonjë nga reaksionet e mësipërme ju është shfaqur bisedoni me mjekun tuaj.

Keni kujdes të veçantë me Enap

Bisedoni me mjekun apo me farmacistin para se të merrni Enap.

Keni kujdes të veçantë me Enap:

- nëse jeni duke u trajtuar për sëmundje të veshkave, nëse jeni duke u trajtuar për hemodializë, nëse jeni në dietë me sasi të vogla kripe, ose nëse së fundi keni vuajtur nga vjellja dhe diarrea (barkqitja);
- nëse jeni duke marrë barna për sëmundje të valvulave të zemrës apo për sëmundje tjera të zemrës;
- nëse keni sëmundje të mëlçisë;
- nëse keni problem me gjak, siç është niveli i ulët apo mungesa e qelizave të bardha të gjakut, numër të ulët të pllakëzave të gjakut apo numër të zvogëluar të qelizave të kuqe të gjakut;
- nëse keni tension të ulët të gjakut (nëse shpesh e humbni vetëdijen ose keni marramendje, e në veçanti gjatë ngritjes në këmbë);
- nëse tash shpejt keni pasur transplantim të veshkës dhe jeni duke marrë barna për parandalimin e refuzimit;
- nëse keni sëmundje tjera të imunitetit ose alergjisë;
- nëse më parë keni përjetuar reaksione të alergjisë me ënjtje të fytyrës, të buzëve, të gjuhës dhe/ose glotis dhe vështirësi në gjëllitje dhe frymëmarrje;
- nëse jeni duke u trajtuar për diabet;
- nëse ju zhvillohet verdhëza;
- nëse paraqitet kollë e thatë dhe e zgjatur;
- nëse jeni duke marrë litium;
- nëse jeni duke marrë ndonjërin nga barërat në vijim, rreziku nga angioedema është i rritur:
 - racecadotril, përdoret për trajtimin e diarresë;
 - barna të cilat përdoren për parandalimin e përjashtimit të organeve të transplantuara dhe për kancerin i cili i takon klasit të inhibitorëve mTOR (p.sh. temsirolimus, sirolimus, everolimus);
 - vildagliptin, bar i cili përdoret për trajtimin e diabetit.
- nëse merrni çfarëdo nga bari në vazhdim që përdoren për trajtimin e presionit të lartë të gjakut:
 - bllokues të receptorëve të angiotensinës II (ARB) (gjithashtu të njohur si sartan – për shembull valsartan, telmisartan, irbesartan), posaçërisht nëse keni sëmundje të veshkave që lidhen me veshkat.
 - aliskiren.

Mjekut tuaj mund t'i duhet të kontrollojë funksionimin e veshkave tuaja, presionin e gjakut si dhe sasinë e elektroliteve (p.sh. kaliumit) në gjak në intervale të rregullta.

Shiko gjithashtu informatat nën titullin “Mos merr Enap”.

Kur mjeku juaj (dentisti) planifikon procedurë kirurgjikale dhe anestezion, trajtim me hemodializë, procedurës për pastrimin e gjakut (aferezë), apo trajtimin që zvogëlon ndjeshmërinë për alergji në thumbim nga bleta/grerëza, tregoni mjekut tuaj që jeni duke marrë enalapril.

Duhet ti tregoni mjekut tuaj nëse mendoni se jeni shtatzënë (ose planifikoni të mbeteni shtatzënë). Enap-i nuk rekomandohet në fillim të shtatzënisë, gjithashtu nuk duhet të merret nëse jeni më shumë

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

se 3 muaj shtatzënë, për shkakun se mund të shkaktojë dëmtime serioze në foshnjën tuaj nëse përdoret në atë fazë (lexoni pjesën të Shtatzënia dhe ushqyerja me gjë).

Enap është më pak efektiv në uljen e presionit të gjakut te pacientët me ngjyrë (racës së zezë) sesa te pacientët e racave tjera.

Fëmijët dhe adoleshentët

Informatat lidhur me përdorimin e Enap te fëmijët që kanë presion të lartë të gjakut është i kufizuar. Enap nuk rekomandohet për përdorim te foshnjat e porsalindura apo fëmijët me funksion të dëmtuar të veshkave.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barna që merren pa recetën e mjekut.

Kjo kryesisht vlen për:

- barërat për presion të lartë të gjakut, insuficiencëtë zemrës,
- tableta uji (diuretikë),
- suplemente të kaliumit (duke përfshirë substituentët e kripërave), diuretikët të cilët ruajnë kaliumin dhe barnat tjera të cilat mund të rritin sasinë e kaliumit në gjak (p.sh. trimetoprim dhe ko- trimoksazol për infeksione të shkaktuara me bakterie; ciklosporina, bar imunopresiv që përdoret për parandalimin e përjashtimit të organeve të transplantuara dhe heparina, bar i cili përdoret për hollimin e gjakut për parandalimin e koagulimit),
- barërat për dhimbje të kyçeve,
- aspirina (acidi acetilsalicilik),
- barërat për çrregullime psikiatrike (duke përfshirë litiumin),
- barërat për diabet,
- preparatet me ar që përdoren për trajtimin e artritit (natrium aurotiomale),
- barnat të cilat më së shpeshti përdoren për parandalimin e përjashtimit të organeve të transplantuara (sirolimus, everolimus dhe barna të tjera nga klasi i mTOR inhibitorëve). Shihni seksionin „Keni kujdes të veçantë me Enap“.
- agjentët që gjenden në disa barëra për kollitje dhe ftohje (simptomimetikët),
- barërat që përdoren për parandalimin e ngjizjes së gjakut (trombolitikët).

Përdorimi i njëkohshëm i enalapril dhe disa barërave që përdoren në trajtimin e sëmundjeve të mësipërme mund të dobësojë efektet e këtyre barërave apo të përforcojë efektet e tyre anësore, mund të ndikojë në efektin e enalapril apo të rrisë rrezikun e përkeqësimit të funksionit të veshkave. Para se mjeku të ju shkruajë çfarëdo barërash, tregoni atij/asaj që jeni duke marrë enalapril.

Mjekut tuaj mund t'i duhet të ndryshojë dozën dhe/apo të marrë masa tjera paraprake:

Nëse jeni duke marrë bllokues të receptorëve të angiotensinës II (ARB) apo aliskiren (shiko gjithashtu informatat nën titujt “Mos merrni Enap” dhe “Keni kujdes të veçantë me Enap”).

Marrja e Enap me ushqim, pije dhe alkool

Enap mund të merret para, gjatë ose pas ushqimit.

Nuk rekomandohet marrja e alkoolit gjatë trajtimit me enalapril pasi që rritë efektin e uljes së presionit të gjakut të enalapril.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkoni këshillë nga mjeku ose farmacisti para përdorimit të barit.

Shtatzënia

Duhet ti tregoni mjekut tuaj nëse mendoni se jeni shtatzënë (ose planifikoni të jeni shtatzënë). Nëse jeni shtatzënë apo duke ushqyer me gjë, mendoni se mund të jeni shtatzënë apo planifikoni të keni një

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

foshnjë, pyesni mjekun apo farmacistin tuaj për këshillë para se të merrni këtë bar. Mjeku juaj normalisht do të ju këshillojë që të ndërprisni marrjen e Enap para se të mbeteni shtatzënë apo posa të dini se jeni shtatzënë dhe do të ju **përshkruajë** ndonjë bar tjetër. Enap-i nuk rekomandohet në fillim të shtatzënisë, gjithashtu nuk duhet të merret nëse jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë, për shkakun se mund të **shkaktojë dëmtime serioze në foshnjen tuaj nëse përdoret në atë fazë.**

Ushqyerja me gji

Tregoni mjekut tuaj nëse jeni duke ushqyer me gji foshnjën ose do të filloni ushqyerjen me gji. Ushqyerja me gji e foshnjeve të porsalindura (javët e para pas lindjes), dhe posaçërisht te foshnjët e lindura parakohe, nuk rekomandohet të merret Enap.

Në rastin kur foshnja është me e madhe mjeku juaj do të ju udhëzon në benefitet dhe rreziqet e marrjes së Enap gjatë ushqyerjes me gji, në krahasim me barnat tjera.

Ngasja e automjeteve dhe përdorimi i makinerive

Kur vozisni mjete motorike apo operoni makineri, mund të paraqiten nganjëherë marramendje dhe lodhje.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Enap

Enap përmban laktozë dhe natrium

Nëse mjeku ju ka thënë se keni jotolerancë në disa sheqerna, kontaktoni mjekun para se të merrni këtë bar.

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23mg) për dozë, që mund të thuhet se në esencë është ‘pa natrium’.

3. SI TA MERRNI ENAP

Gjithmonë merrni Enap saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt.

Trajtimi i tensionit të lartë të gjakut

Doza fillestare e zakonshme e Enap për trajtimin e rritjes së tensionit të gjakut është 5 mg deri në 20 mg. Merrni barin një herë në ditë. Doza fillestare e rekomandura për pacientët me rritje të lehtë të tensionit të gjakut është 5 mg deri në 10 mg në ditë. Doza mbajtëse e zakonshme është 20 mg një herë në ditë. Doza ditore maksimale është 40 mg.

Nëse jeni duke marrë doza të larta të diuretikëve para fillimit të trajtimit me Enap, doza fillestare e rekomanduar është 5 mg ose më pak. Nëse është e mundshme, mjeku juaj do të ju kërkojë që të ndërprisni marrjen e diuretikëve dy deri tri ditë para se të filloni trajtimin me Enap.

Trajtimi i insuficiençës së zemrës/parandalimi i përkeqësimit të funksionit të zemrës

Doza fillestare e rekomanduar është 2,5 mg një herë në ditë. Doza mund të rritet gradualisht në dozën mbajtëse të zakonshme maksimale është 20 mg dy herë në ditë. Doza maksimale ditore është 40 mg e ndarë në dy ditë.

Dozimi për pacientët me dëmtim të funksionit të veshkës

Mjeku vendosë dozën e duhur bazuar në shkallën e dëmtimit të funksionit të veshkave.

Pacientët në hemodializë

Merrni 2,5 mg Enap në ditën e hemodializës; në ditën kur nuk bëhet hemodializë, mjeku do të rregullojë dozën varësisht nga niveli i tensionit të gjakut.

Përdorimi te fëmijët

Doza për fëmijët do të përcaktohet nga mjeku.

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Përvoja me përdorimin e Enap te fëmijët me presion të lartë të gjakut është e kufizuar. Nëse fëmija mund të gëlltisë tabletat, doza do të përcaktohet në bazë të peshës së fëmijës dhe presionit të gjakut.

Dozat e zakonshme fillestare janë:

- te fëmijët që peshojnë në mes 20 kg dhe 50 kg: 2,5 mg enalapril një herë në ditë
- te fëmijët që peshojnë më shumë se 50 kg: 5 mg enalapril një herë në ditë

Doza mund të ndryshohet bazuar në nevojat e fëmijës:

- më së shumti 20 mg në ditë mund të përdoret te fëmijët që peshojnë në mes 20 kg dhe 50 kg;
- më së shumti 40 mg në ditë mund të përdoret te fëmijët që peshojnë më shumë se 50 kg.

Enap nuk rekomandohet për përdorim te foshnjat e porsalindura dhe te fëmijët me probleme me veshka.

Ushtroni kujdes të veçantë kur merrni dozën fillestare dhe dozën e parë më të lartë. Nëse përjetoni marramendje apo vertigo kontaktoni menjëherë mjekun tuaj.

Nëse mendoni se efekti i Enap-it është shumë i fortë ose shumë i dobët, bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Nëse merrni Enap më shumë se që duhet

Shenjat më të shpeshta të mbidozimit ulje shumë e madhe e tensionit të gjakut (hipotension). Në të tilla raste shtrihuni me kokën poshtë dhe njoftoni mjekun.

Nëse fëmiju ka marrë barin gabimisht kontaktoni mjekun menjëherë.

Nëse harroni të merrni Enap

Mos e dyfishoni dozën për ta kompensuar dozën e humbur.

Nëse keni harruar të merrni dozën e Enap, merreni dozën tjetër në kohën e zakonshme.

Nëse e ndërprisni marrjen e Enap

Pas ndërprerjes së trajtimit, presioni juaj i gjakut mund të rritet prapë me kalimin e kohës dhe kjo mund të rrisë rrezikun e komplikimeve për shkak të presionit të lartë të gjakut, posaçërisht në zemër, tru dhe veshka.

Gjendja e pacientëve me insuficiencë të zemrës mund të përkeqësohet as shumë sa të kenë nevojë për hospitalizim.

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtoheni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Enap mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse ato nuk paraqiten te të gjithë.

Shumë e zakonshme: mund të prekë më shumë se 1 në 10 njerëz

- të pamur të paqartë (të turbulluar),
- marramendje,
- kollitje,
- nauze,
- mungesë e fuqisë (asteni).

E zakonshme: mund të prekë deri në 1 në 10 njerëz

- dhimbje koke, depresion,
- presion të ulët të gjakut, të fikët (sinkope), dhimbje gjoksi, çrregullime të ritmit të zemrës, angina pectoris, rrahje të shpejta të zemrës,
- vështirësi në frymëmarrje (dispnea),

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

- diarre, dhimbje abdominale, ndryshime në shije,
- skuqe e lëkurës, reaksione alergjike me ënjtje të fytyrës, ekstremiteteve, buzëve, gjuhës dhe/ose fytyrës me vështirësi në gëlltitje dhe frymëmarrje,
- lodhje,
- rritje e niveleve të kaliumit, rritje e niveleve të kreatininës në serum.

E pazakontë: mund të prekë deri në 1 në 100 njerëz

- anemi,
- nivele të ulëta të sheqerit në gjak,
- konfuzion, përgjumje apo pamundësi për të fjetur, nervozizëm, ndjesi shpimi apo gjilpërash në duar dhe këmbë (parestezoni), vertigo (ndjesi rrotullimi),
- rënie e presionit të gjakut gjatë ngritjes së shpejtë nga pozita e ulur apo e shtrirë, rrahje të shpejta të fuqishme të zemrës (palpitacione), sulm në zemër apo në tru, me siguri për shkak të presionit shumë të ulët të gjakut te pacientët me rrezikshmëri të lartë për komplikime kardiovaskulare,
- rrjedhje hunde (rinorea), skuqe e fytyrës, ngjirje e zërit, astma,
- pengim në zorrë (ileus), inflamacion të pankreasit (pankreatit), mundim (vjellje), çrregullime gastrointestinale (dispepsi), konstipacion, iritacion stomaku, tharje e gojës, humbje e apetitit (anoreksi), ulcer në stomak,
- djersitje, kruajtje, skuqe e hithrave (urtikarie), rënie flokësh,
- funksion i zvogëluar i veshkave, insuficiencë e veshkave, prani e proteinave në urinë (proteinuria),
- pamundësi seksuale të meshkujt (impotencë),
- ngërçe muskujsh, skuqe e fytyrës, tringëllimë në vesh (tinitus) temperaturë, mundim i përgjithshëm (malaizë),
- nivele të lartë të uresë në serum, nivele të ulëta të natriumit në gjak.

E rrallë: mund të prekë deri në 1 në 1,000 njerëz

- ndryshime në vlerat e gjakut (numër më i ulët e qelizave të bardha dhe të kuqe të gjakut, hemoglobinë më e ulët, numër më i ulët i pllakëzave të gjakut), sëmundje autoimune,
- verdhëza, nivel më i ulët i prodhimit të urinës,
- ëndrra të jonormale, çrregullime të gjumit,
- zbehje e rastit e gishtave të dorës dhe këmbës (sindroma e Raynaud),
- lëng në mushkëri, inflamacion i membranës së mukozës nazale, pneumoni,
- ënjtje ose ulcerim i gojës, infeksion ose dhimbje dhe gjuhë e enjtur
- insuficiencë e mëlçisë, inflamacion i mëlçisë, obstruksion biliar, që mund të çojë në zverdhjen e lëkurës (verdhëz),
- skuqe e lëkurës, fluska dhe inflamacion i lëkurës, posaçërisht në duar dhe këmbë, në gojë apo rreth gojës, dhe ethe (sindroma Stevens-Johnson), qërim i lëkurës,
- sasi e zvogëluar e urinës,
- rritje e gjoksit të meshkujt (ginekomastia),
- ngritje e niveleve të enzimës së mëlçisë, rritje e bilirubinës.

Shumë e rrallë: mund të prekë deri në 1 në 10,000 njerëz

- ënjtje e mukozës së zorrëve.

Nuk dihen: shpeshësia nuk mund të vlerësohet nga të dhënat në dispozicion

- sindroma e sekretimit të papërshtatshëm të hormonit antidiuretik (SIADH).

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk përfshihet në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

Raportimi i efekteve anësore

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Nëse keni ndonjë efekt anësor, bisedoni me mjekun tuaj apo farmacistin. Këtu përfshihen çfarëdo efekte anësore që nuk janë listuar në këtë fletudhëzim. Ju gjithashtu mund të raportoni efektet anësore drejtpërdrejt përmes sistemit kombëtar të raportimit.

Duke raportuar efektet anësore, ju mund të ndihmoni në ofrimin e më shumë informatave për sigurinë e këtij bari.

5. SI TË RUHET ENAP

Fëmijët të mos kenë qasje në këtë bar.

Mos e përdorni Enap pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Të ruhet në temperaturë deri në 25°C.
Të ruhet në paketim origjinal që të mbrohet nga lagështia.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave shtëpiake. Pyeteni farmacistin se si t'i largoni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta ruajtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Enap

Substanca aktive është: enalapril maleat.

1 tabletë përmban 5 mg, 10 mg ose 20 mg enalapril maleat, që është ekuivalent me 3,8 mg, 7,6 mg ose 15,3 mg enalapril.

Përbërësit e tjerë të 5 mg tabletave janë: monohidrat laktoze, celulozë hidroksipropil (E463), amidon misri, karbonat hidrogjen natriumi, talk (E553b), stearat magnezi (E470b).

Përbërësit e tjerë të 10 mg tabletave janë: monohidrat laktoze, amidon misri, karbonat hidrogjen natriumi, talk (E553b), stearat magnezi (E470b), oksidi i kuq i hekurit (E172).

Përbërësit e tjerë të 20 mg tabletave janë: monohidrat laktoze, amidon misri, karbonat hidrogjen natriumi, talk (E553b), stearat magnezi (E470b), oksidi i kuq i hekurit (E172) dhe oksidi i verdhë i hekurit (E172).

Shihni seksionin 2 “Enap përmban laktozë dhe natrium”.

Si duket bari Enap dhe përbërja e paketimit

Tabletat 5 mg janë të bardha, të rrumbullakëta, të rrafshëta dhe të shënuara në me vizë në mes në njërën anë. Tableta mund të ndahet në dy doza të barabarta.

Tabletat 10 mg janë të kuqe në të kaftë, të rrumbullakëta, të rrafshëta dhe të shënuara në me vizë në mes në njërën anë. Viza e shënuar nuk ka për qëllim ndarjen e tabletës.

Tabletat 20 mg janë ngjyrë portokalli e çelët, të rrumbullakëta, të rrafshëta dhe të shënuara me vizë në mes në njërën anë. Viza e shënuar nuk ka për qëllim ndarjen e tabletës.

Tabletat Enap të të gjitha dozave janë në dispozicion në kuti prej 20 tabletave në blister. Kutitë përmbajnë 2 blistera prej 10 tabletave.

Bartësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,
fax: +386 7 332 27 42
www.krka.si

1.3.1	Enalapril maleate
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet me recetë të mjekut.

Data e fundit e miratimit të fletudhëzimit

04/2020